

## PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Mbikëqyrje E Punimeve Të Zbatimit Për Objektet E Programeve Të Financuara Nga Buxheti I Shtetit Dhe Buxheti I Bashkisë”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Shërbime të mbikëqyrjes 79714000-2

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4 058 282** *(katër milion e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy) Lekë, pa TVSH*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor **Bashkia Dimal** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:
  - a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
  - b. *Përshkrimin e Ofertës ;*
  - c. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

##### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithsme sipas shtojcës 9

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

##### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019-2020-2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerë se perlllogaritur të kontratës ose lotit.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga autoriteti përgjegjës për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: *Lloji i procedure eshte "Hapur", percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "b" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar *ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku percaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, date 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, I ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të ketij ligji.*

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50*

*milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41,

2.3.2 Për mbikqyrjen e punimeve të pergjithshme të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licensat e mëposhtme:

- N.P – 1. Punime gjermimi në tokë.
- N.P – 3. Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
- N.P – 4. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- N.P – 7. Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
- N.P – 8. Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje.
- N.P – 11. Ndertime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.P – 12. Punime të inxhinierisë së mjedisit.

**Për mbikqyrjen e punimeve speciale të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licensat e mëposhtme:**

- N.S – 1. Punime për prishjen e ndertimeve
- N.S – 4. Punime rifiniture të muratues dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese.
- N.S – 6. Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- N.S – 8. Ndertime parafabrikate beton arme, struktura metalike dhe druri.
- N.S – 18 Punime topogjeodezike
- NS - 20 Punime Gjeologjike

Llogaritja të bëhet duke u mbështetur në VKM nr. 354, datë 23/05/2016 (Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Teritori, Projektim, Mbikeqyrje dhe Kolaudim),

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

*Meqenese kemi te bejme me Mbikqyrjen e punimeve ne zbatim argumentojme se Kategorite e mesiperme jane përcaktuar ne perputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit.*

**2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të kete minimalisht **jo me pak se 17 (Shtatwmbedhete ) punonjës te siguruar** per periudhen (Maj 2022 – Gusht 2022). Per te vertetuar kete kusht, Operatori Ekonomik duhet te paraqese vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen 3 mujore të specifikuar/përzgjedhur.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur duke u bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te references,

#### **2.3.4. Staf kryesor, punonjesit, çertifikimet**

Operatori Ekonomik duhet te kete të përfshirë në ekipin e tij stafin kryesor si Drejtues Teknik te Perfshire ne Licencen e Shoqerise sipas fushave te ekspertizes, qe do te realizoje ndjekjen e sherbimit te mbikqyrjes, minimalisht si me poshte:

Nr	
	<u>Staf kryesor sipas fushave te ekspertizes</u>
2 (dy)	Inxhinier Ndertimi
2 (dy)	Inxhinier Gjeodet

1 (një)	Inxhinier Elektrik
1 (një)	Inxhinier Hidroteknik
1 (një)	Inxhinier Mjedisi/Kimist Teknolog
1(një)	Arkitekt
1(një)	Inxhinier Mekanik

Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, te kete të përfshirë në ekipin e tij dhe te propozoje per realizimin e shërbimeve objekt kontrate, 2 (dy) Staf si Inxhinier Resident, qe do te ndjekin punimet dhe duhet te jene present çdo dite ne terren. Ne cdo kantier te kontratave qe do zbatohen, do te jete e nevojshme presenca e nje Inxhinieri Resident. Ne cdo rast, ne varesi te nr te objekteve qe do te zbatohen ne te njejtën kohe, mbikeqyresi duhet te shprehe gatishmerine dhe te marre parasysh prezencën e nje inxhinieri rezident ne secilin kantier punimesh. (OE duhet te sjelle nje deklarate lidhur me kete)

**Për stafin e mësipërm të paraqiten:**

- CV
- Kontrate pune
- License Individuale ne Sherbimin e Mbikqyrjes.
- Kualifikimet arsimore/Diploma/certifikata/ kualifikime profesionale

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

***Shenim: Për efekt të vlerësimit me pike sipas pikës 4.4 ne Njoftimin e Kontrates, operatorët të ngarkojnë dokumentacionin:***

- CV
- Kontrate pune
- License Individuale ne Sherbimin e Mbikqyrjes.
- Kualifikimet arsimore/Diploma/certifikata/ kualifikime profesionale

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes së punimeve të zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për periudhën **Maj 2022- Gusht 2022**, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për kryerjen e shërbimit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjet është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve.

B. Operatori ekonomik duhet të disponojë staf ndihmës vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë/dëshmi kualifikimi dhe të vërtetuar në listpagesa për Periudhën (Maj 2022 – Gusht 2022), si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi Profili Infrastruktura Transporti /Rruge
- 1 (një) Inxhinier Ndertimi Profili Strukturist
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi / Kimist Teknolog
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Agronom
- 1 (një) Kontrollor i volumeve të punës
- 1 (nje) Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE)
- 1 (një) Kontrollor Cilesie
- 1(nje) Ekspert Zjarrfikes

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Stafi inxhinierik mbështetës që do të realizojë mbikqyrjet është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve. Ky staf duhet për shkak se janë shumë objekte në zbatim dhe janë në zonë të ndryshme ndërtimi, pra kemi të bëjmë me një kompleksitet objektësh.

Kriteri për stafin ndihmes, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për stafin ndihmes në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes së punimeve të zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit ndihmes është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën 3 (tre) muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

### **2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:**

A. Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qira instrumentat topografike si më poshtë:

- Pajisje GPS Rover 2 (dy) copë;
- Pajisje Total Station 2 (dy) copë;

Në lidhje me sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Fatura Tatimore shitblerje ose Kontratë Qiraje të noterizuar (origjinal ose fotokopje e noterizuar).

B. Kandidati/ ofertuesi për realizimin e kontratës duhet të disponojë 2 (dy) mjet transporti të specialistëve. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik. Për të dëshmuar këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat e mëposhtme:

1. Për mjetet në pronësi që shihen në Regjistrat publike, duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë rregjistrimin e mjetit si: Leje Qarkullimi, Siguracionin e mjetit dhe Çertifikatën e Kontrollit teknik.
2. Për mjete të marra me qira dokumentave të mesipër të bashkëlidhen Kontrata perkatëse të qerash / leasing / huapërdorjes, në emër të objektit, të jenë të lidhura para noterit dhe afati i të cilave të përfshijë periudhën e ndërtimit të objektit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mjetet e mesipërme janë vendosur në përputhje me natyrën e punimeve dhe volumin e punimeve të përcaktuar në preventivin e punimeve.

Numri i paisjeve dhe i makinave te transportit jane vleresuar si te nevojshme ne perpjesetim me natyren e kontrates, duke iu referuar grafikut te punimeve, kohezgjatjes se punimeve dhe specifikimeve teknike te punimeve.

Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- a) Çertifikate ISO 9001-2015 "Per sistem menaxherial te cilesise", te vlefshme ose ekuivalente.
- b) Çertifikate ISO 14001-2015 "Per sistem menaxherial te mjedisit", te vlefshme ose ekuivalente.
- c) Çertifikate ISO 18001-2007 ose 45001-2018 "Per sistem menaxherial te shendetit dhe sigurise ne pune", te vlefshme ose ekuivalente.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë, janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.